

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA ARTESA OSMANAJ- MAVRAJ

Proza sentimentaliste shqipe (Mihal Grameno, Foqion Postoli, Haki Stërmilli)

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2022

UNIVERSITY OF PRISHTINA

FACULTY OF FILOLOGY



MA ARTESA OSMANAJ- MAVRAJ

**The sentimental albanian prose (Mihal Grameno,
Foqion Postoli, Haki Stërmilli)**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2022

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA ARTESA OSMANAJ- MAVRAJ

Proza sentimentaliste shqipe (Mihal Grameno, Foqion Postoli, Haki Stërmilli)

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori: Prof. dr. Osman Gashi

Prishtinë, 2022

REZYMEJA

Gjatë studimit “Proza sentimentale në letërsinë shqipe (Mihal Grameno, Foqion Postoli, Haki Stërmilli), synuam që të arrijmë në një konkludim që; proza sentimentale shqipe, solli risi duke sublimuar kështu karakteristikat e fenomenit të sentimentalizmit e duke shenjuar tema e motive të reja, të ndryshme e të rëndësishme për letërsinë shqiptare.

Në këtë studim u trajtua proza sentimentale shqipe respektivisht romanet e Haki Stërmitit “Sikur t’isha djalë”, Foqion Postolit “Lulja e kujtimit”, “Për mbrojtjen e atdheut”, novelat e Mihal Gramenos; “E puthura”, “Varri i pagëzimit”, “Oxhaku”, si vepra përfaqësuese të autorëve të cilat na ofruan mundësi të shumta interpretimi dhe diskutimi për to dhe të cilat pasurojnë letërsinë shqipe me temat që trajtojnë. Në këtë studim analitik dhe krahasimtar, vlera e prozës sentimentale shqipe është parë në vepra të veçanta, të cilat analizohen, krahasohen, për të arritur një pasqyrë të plotë mbi veprat që i kishim objekt studimi.

Ne kemi lexuar dhe interpretuar romanet e novelat e autorëve shqiptarë pa i lënë anash edhe romanet sentimentale evropiane si; “Vuajtjet e djaloshit Verter”, Gëte, “Pamela”, Samuel Richardson, “Ema” dhe “Krenari dhe paragjykim” të Jane Austen, e romane të tjera që lidhen në kontekst të temës. Kemi arritur në përfundim që përpos risive që sollën këto romane, autorët arritën deri diku vlerësimin nga kritika letrare shqiptare, si dhe u bënë shkrimtarët më të lexuar nga lexuesi shqiptar i kohës. Mendojmë që edhe sot e kësaj dite, romanet e tyre vazhdojnë të jenë më të kërkuarat nga artdashësit shqiptarë .

E veçanta e këtyre romaneve të autorëve sentimentalë shqiptarë në krahasim me romanet e tjera shqiptare të autorëve të tjerë është se në qendër të fokusimit të tyre e kanë njeriun dhe i rreken trajtimin të krajetave të njeriut të thjeshtë përballë periudhave të vështira të historisë shqiptare. Kjo edhe është edhe pikë përbashkuese e romaneve të autorëve tanë shqiptarë me autorët sentimentalë evropianë. Grameno, Postoli e Stërmilli si prozatorë janë specifik në mënyrën e modelimit të narracionit, me një lëvizje të kohëve dhe perspektivave të rrëfimit. Një lëvizje e tillë, sa në të tashmen e sa në të kaluarën është shënjuese e mënyrës së rrëfimit të këtyre autorëve. Rrëfimin e tyre, përpos lëvizshmërisë së kohës, e karakterizon edhe lëvizja e hapësirave të rrëfimit, ambienteve në të cilat e për të cilat zhvillohet rrëfimi. Kjo padyshim që i jep romaneve një pamje

më ndryshe duke i bërë më të kapshëm për interpretim dhe analizë të tyre. Ndryshimet e vetave në rrëfim gjithashtu janë karakteristikë e romaneve ku hetohet edhe narratori i brendshëm (homodiegetik) edhe narratori i jashtëm (heterodiegetik). Më të rrallë, por jo për nga rëndësia e kemi narratorin homodiegetik (vetën e parë), dhe më shpesh të përdorur vetën e tretë të cilën na jep zakonisht narratori heterodiegetik. Kjo lojë narrative vërehet varësisht prej ndryshimeve tematike dhe me ndryshimin e perspektivave dhe qasjes së personazheve ndaj të tjerëve që janë akterë në rrëfimin e secilit roman.

Pasi që lënda kryesore e këtij punimi ka qenë sentimentalizmi, e kemi parë të nevojshme që ky punim doktorate të fillojë me një vështrim mbi sentimentalizmin dhe çështje të tjera që lidhen me të dhe letërsinë, pra me një mbështetje teorike.

Janë dhënë përkufizime të ndryshme mbi sentimentalizmin, konceptin në pamjen teorike në pjesë të shkurtër sqaruese, duke e shikuar rrjedhën e tij në Evropë dhe në letërsinë shqiptare. Gradualisht kemi arritur deri te një vlerësim përfundimtar rreth përkufizimit të sentimentalizmit dhe objektit të tij, duke e parë edhe në vepra konkrete të letërsisë shqiptare dhe angleze. Kështu teoria ka qenë sado pak një mbështetje, prej së cilës jemi nisur për të depërtuar në oazën romanore të autorëve sentimentalë shqiptar dhe evropianë.

Në kapitullin e parë është trajtuar krijimtaria e Mihal Gramenos, konkretisht novelat e tij, ku është e arsyeshme ta themi që këto novela meritojnë më shumë vend në studimet letrare. Sapo të lexosh novelat e Gramenos dhe ndalesh në veçanti, në analizën e tyre, kupton që temat e ndryshme që lidhen me frymën dhe elementet sentimentale, diku strukturohen si tema e diku si motive. Përveç analizës së subjektit, është bërë analizë e personazheve me gjithë trazimet shpirtërore të tyre, është parë e përbashkëta që i mbizotëron të tri novelat pa e lënë anash gjuhën dhe stilin që e karakterizon autorin. Gjatë rrjedhës së këtij studimi kemi theksuar edhe përpjekjet e këtij autori dhe të tjerëve për të depërtuar në botën e brendshme të personazheve kryesore, veçanërisht të të rinjve të dashuruar, duke na krijuar emocione nga më shpirtëroret deri te mendimet më kurreshtare për fatin e tyre.

Elaborimi i temave të ky autor është parë në relacion me elemente shoqërore në përgjithësi, fenomene shoqërore dhe probleme sepse padyshim vepra e tij është pasqyrë e gjallë e vendit dhe historisë së tij. Njësoj si të tjerat vepra të autorëve sentimentalë shqiptarë, edhe vepra e Gramenos, në asnjë rast nuk është zhveshur nga ndjenja, emocioni, përjetimi, thënë shkurt sentimentalizmi artistik. Që të dalë sa më i plotë portreti i autorëve Grameno, Postoli dhe Stërmilli, si nismëtarë të

prozës sentimentale shqipe, e kemi parë të domosdoshme që në secilin kapitull mbi veprat e autorëve, fillimisht të shohim edhe përtej krijimtarisë letrare, në pjesë të shkurtëra, jeta dhe vepra, pra edhe si gazetarë, publicistë, patriotë me gjurmën e pashlyeshme.

Në kapitullin e dytë përfshihet prapë trajtimi i prozës me elemente sentimentale, kësaj radhe e autorit Foqion Postoli, pikërisht romanet e tij: “Lulja e kujtimit” dhe “Për mbrojtjen e atdheut”. Natyra e analizës të ky autor është përqendruar gjithashtu në elemente si; subjekti, struktura, personazhet, tema, motivi, por edhe në disa pamje shtesë si karakteristikat e gruas, letërkëmbimet, kultin, pa lënë anash gjuhën dhe stilin gjithashtu. Proza e Postolit është parë detajisht për të pasur qasje më të lehtë në trajtimin e interpretimin e saj duke identifikuar edhe simbolikën që e përshkon atë që nga titujt e romaneve, e në fund duke ofruar në këtë mënyrë, mjetet ndërtuese të prozës sentimentale të autorit. Në prozën e vet, Postoli përshkruan ngjarje e situata, të cilat sikur i shohim dokumente të gjalla të kohës e të ambientit me personazhe sentimentale e patriotike. Personazhet e Postolit i shquan veçanërisht lidhshmëria me tema patriotike, pa i lënë anash edhe ato të dashurisë. Ata janë të lidhur me çështje të rëndësishme të kombit, çlirimin e atdheut, ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqipe dhe kështu duke kryer një funksion, ata shprehin një qëndrim të autorit.

Proza sentimentale e Haki Stërmillit është trajtuar **në kapitullin e tretë**. Në një shqyrtim të brendshëm të kësaj proze, kemi vënë re se autori përmes një ditari që mban personazhi kryesor Dijsa, që është një mënyrë procedimi nga më të zakonshmit në romanin sentimentalist, shfaq fuqishëm temën sociale me shprehje sentimentale e motivin e dashurisë. Femra është objekt shqyrtimi në këtë roman, ku autori deshi të theksojë përpjekjet e vazhdueshme për emancipimin e saj.

Është hetuar frymë e theksueshme sentimentale ku femra vihet përballë padrejtësive, përjetimeve, zakoneve, sëmundjes, e vdekjes. Është bërë analizë e diskursit që e karakterizon prozën e Stërmillit, temës, strukturës, motivit, gruas, personazheve, pa lënë anash edhe shprehjet frazeologjike dhe gjuhën e përdorur. Autori mundohet të mbajë një qëndrim të drejtë dhe të palëkundur për lirimin e saj nga prangat shekullore që e kanë shtypur, përulur e nënshtruar, por me fundin e romanit nuk ia del të na japë një zgjidhje të duhur. Duke pasur strumbullar rrëfimi fatin e mjerë të vajzës, që shërbeu si objekt në duart e prindit, që bëjnë si të duan me fatin e tyre, romani i ngjan një drame trishtuese, me fytyrën e ndritshme të Dijes, bujare e trimëreshë, që thyen rregullat e nënshtrimit, por fatkeqësisht nuk ia del të kap në dorë fatin e saj.

Veçanërisht interesante në këtë kapitull janë edhe këndvështrimet mbi trekëndëshin familjar që paraqet autori në roman, rolin e fesë, apo ritet fetare dhe veçoritë e gruas si krenari e shoqërisë me moralin dhe traditën, por edhe si dhembje e pashëruar e kohës.

Pas gjithë punës së bërë mbi studimin e autorëve ndaras prej njëri-tjetrit, është parë e rrugës që punimi të përmbillet me **një kapitull të katërt**, të quajtur “Proza sentimentale shqipe në kontekstin krahasimtar”, me një vështrim përmbledhës, që në qendër do të ketë ballafaqimin e të përbashkëtave mes tyre. Në këtë kapitull jemi përqëndruar në krahasime kryesisht të planit tematiko-përmbajtësor të krijimtarisë së autorëve shqiptarë dhe atyre evropianë.

Duke qenë autorë me të njëjtën frymë letrare, të vendosurit pranë njëri-tjetrit na ndihmoi që të vëmë në pah afritë apo ndonjë diferencë që kanë mes vete. Krahasimi mes tyre apo edhe hetimi i niveleve të intertekstualitetit të njëri apo të tjetri autor, na ka ndihmuar që të vëmë në pah karakteristika të këtyre autorëve. Janë bërë analiza krahasimtare, në përgjithësi në mes prozës sentimentale shqipe dhe asaj evropiane. Edhe pse në tërë kapitujt e mëparshëm ne kemi bërë gjithashtu krahasime të dukshme, të vazhdueshme, ky kapitull thekson dhe heton më shumë elementet esenciale që i përbashkon prozën sentimentale shqipe në mes vete dhe prozën sentimentale shqipe me atë evropiane. Komunikimet intertekstuale që janë të shprehura në mes këtyre prozave gjithashtu edhe në mes Spases e Verterit apo Stërmillit dhe Richardsonit janë vënë re me kujdes, duke analizuar romanet në veçanti dhe elementet e tjera të prozës në përgjithësi. Jemi ndalur të rrëfimi autobiografik, fenomeni i vetëvrasjes, raportet familjare për të cilat është hulumtuar, ku nga analiza krahasimtare janë nxjerrë rezultate të ndryshme.

Çka kemi arritur si përfundim për romanet sentimentale shqipe dhe në krahasim me ato evropiane? Gjatë analizës tematike mbi romanet e autorëve sentimentalë shqiptarë kemi arritur në përfundim se shikuar në këtë aspekt tematik, letërsia e këtyre autorëve prek tema a rrëfime të mëdha, atë për patriarkalizmin shqiptar, emancipimin e femrës-shoqërisë, ruajtjen e gjuhës dhe kombit shqiptar, gjakmarrjen, vetëvrasjen, dashurinë, etj. Edhe pse thuaja në të gjitha romanet këto aspekte tematike i shohim bashkë, në të njëjtin rrëfim e tekst letrar, secili prej autorëve kërkon qasje të veçantë. Romanet e këtyre autorëve kanë tema dhe motive që herë pas here barten te njëri-tjetri. Pra, temat pak a shumë të njëjta shihen të trajtuara në disa romane të cilat e bëjnë rrëfimin e tyre të larmishëm dhe më atraktiv për lexim dhe interpretim. Pena e autorëve sentimentalë shqiptarë, ka lartësuar disa nga karakteristikat e popullit tonë, siç ishin dashuria e çiltër për vendin (atdheun),

në mes djalit dhe vajzës, nderi, besnikëria, por edhe ka demaskuar doke e zakone të vjetra që sillnin prapambeturi e varfëri.

Duke qenë se krijimtaria letrare e Mihal Gramenos, Haki Stërmillit, Foqion Postolit, është pasqyrë e jetës së kohës ashtu siç e kanë parë e përjetuar, paraqet vlerë në rrafsh të ndryshme studimi si në atë tematik, ideor, motivor, stilistik, historik, politik e personal sepse është parë në mënyrë të detajuar me një paraqitje gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të sjellim një interpretim nga këndvështrimi ynë personal rreth frymës apo dukurisë së sentimentalizmit, të pranishëm në shkrimet e tyre.

Fjalët kyçe: *letërsia shqipe, sentimentalizmi, proza, autorët*

SUMMARY

During the study titled “Sentimental prose in Albanian literature” (Mihal Grameno, Foqion Postoli, Haki Stërmilli), we aimed to reach a conclusion; and the conclusion is that the Albanian sentimental prose, brought innovation, thus sublimating the characteristics of the phenomenon of sentimentality and marking new, different and important themes and motives for Albanian literature.

In this study, it has been analyzed the Albanian sentimental prose, respectively the novels of; Haki Stërmilli "If I were a boy", Foqion Postoli "Flower of memory", "For the protection of the homeland", Mihal Gramenos' novels “The kiss”, “The tomb of baptism”, “The chimney”, The above mentioned are representative works of the authors which offered us numerous opportunities of interpreting and discussing them and which enrich the Albanian literature with the topics they deal with. In this analytical and comparative study, the value of Albanian sentimental prose is seen in these specific works, which are analyzed and compared, in order to achieve a complete picture of the works that we got as the object of study.

We have read and interpreted the novels of Albanian authors without leaving aside the sentimental European novels such as; "The Sufferings of Boy Verter", Goethe, "Pamela", Samuel Richardson, "Emma" and "Pride and Prejudice" by Jane Austen, and other novels related to the context of the theme. We have come to the conclusion that these novels not only brought new as works, but the authors also achieved significant appreciation from Albanian literary criticism. They also became the most favorite writers to be read by Albanian and foreign readers.

We think that even today, their novels continue to be the most preferred to be read by Albanian art lovers. The peculiarity of these specific chosen novels of sentimental Albanian authors in comparison to other Albanian novels and authors, is that they have the individual on focus and they strive to treat the problems of the common man facing difficult times and periods of Albanian history. This fact is also the unifying point of the novels of our Albanian authors with the sentimental European authors. Grameno, Postoli and Stërmilli as prose writers are specific in the way of narration modeling, with a movement of times and perspectives of the narrative.

Such a movement, either in the past or present, is a marking sign of narration style of these authors. Their narrative, beside the mobility of time, is also characterized by the displacement of narration scene that is, the environment where the narrative takes place, or the environment that is being narrated about. This obviously gives the novels a different look, making them more accessible for their interpretation and analysis. Changes in narration from the first person singular to the third, are also characteristic of novels where both the internal narrator (homodiegetic) and the external narrator (heterodiegetic) are noticed. Rarely, but not less important we have the homodiegetic narrator (first person), and most often we use the third person which is usually shown to us by the heterodiegetic narrator. This narrative game comes out due to thematic and perspectives changes and the access that the characters have toward the others who are actors in narrating each novel. Since sentimentalism has been the main subject of this paper, we have found it necessary for this doctoral thesis to begin with a look at sentimentalism and other issues related to it and literature, i.e. with a theoretical support. Different definitions are given on sentimentality, the concept in the theoretical aspect in a short explanatory part, looking at its course in Europe and in Albanian literature. We gradually reach a final assessment about the definition of sentimentality and its object, seeing it in concrete works of Albanian and English literature. . Thus, the theory has been at least a kind of support, from which we started to penetrate the novel oasis of Albanian and European sentimental authors.

The first chapter deals with the creativity of Mihal Grameno, specifically his novels. It is reasonable to say that these novels deserve more place in literary studies. Once you read Grameno's novels and once you particularly stop into their analysis, you realize that the various themes related to spirit and sentimental elements are sometimes structured as themes and sometimes as motives. In addition to the analysis of the subject, an analysis of the characters despite all their spiritual turmoil has been made. It is so evident the common characteristic which is clearly seen in all three novels of him without neglecting the language and style that characterizes the author. During the course of this study we have also emphasized the efforts of this author and others to penetrate into the inner world of the main characters, especially young lovers, creating emotions from the most spiritual to the most curious thoughts about their fate.

The elaboration of the themes by this author is analyzed in relation to social elements in general, social phenomena and problems because undoubtedly his work is a living reflection of his country and its history. Like other works of Albanian sentimental authors, the work of Grameno, in no case

has been stripped of feeling, emotion, experience, in short, artistic sentimentality. In order to have a more complete portrait of the above mentioned authors Grameno, Postoli and Stërmilli, as initiators of Albanian sentimental prose, we have considered it necessary for each chapter on the works of these authors, to first have a look beyond literary creativity, shortly into life and work, but also as journalists, publicists, patriots with indelible traces.

In the second chapter it is again included the development of prose with sentimental elements, this time by the author Foqion Postoli, more precisely his novels: "The flower of memory" and "For the protection of the homeland". The nature of the analysis of this author work is not only focused on elements such as; the subject, the structure, the characters, the theme, the motive, but also in some additional images such as the characteristics of the woman, the correspondence, the cult, not leaving aside without mentioning the language and style as well. Postoli's prose has been studied in details in order to have an easier access to its treatment and interpretation by identifying the symbolism that pervades it from the titles of the novels, and finally offering in this way, the constructive tools of the author's sentimental prose. In his prose, Postoli describes events and situations, in a way which give us the impression as if you are seeing living documents of the time and the place with sentimental and patriotic characters. Postol's characters are especially distinguished by their connection with patriotic themes, not leaving apart without mentioning those of love. They are closely related to important issues of the nation, the liberation of the homeland, the preservation of the Albanian language and culture. This way by performing a function they express an attitude of the author.

We have dealt with Haki Stërmilli's sentimental prose **in the third chapter**. In an internal review of this prose, we have noticed that the author through a diary kept by the main character Dijsa, which is a way from the most common of proceeding in the sentimentalist novel, strongly displays the social theme with sentimental expressions and the motive of love. The female is the object of scrutiny in this novel, where the author wants to emphasize the ongoing efforts for her emancipation.

It has been detected a strong sentimental spirit, which introduces us to the fact that women are confronted with injustices, experiences, habits, illness, and death. It has been made an analysis of the discourse that characterizes Stërmilli's prose, theme, structure, motive, woman, characters, without leaving aside the phraseological expressions and the language used. The author tries to maintain a right and steady attitude about her release from the centuries-old shackles that have

oppressed, humbled and subjugated her, but at the end of the novel he fails to give us a proper solution. Pivoting the story of the miserable fate of the girl, who served as an object in the hands of the parent, who do as they please with their fate, the novel resembles to a sad drama, with the bright face of DiJa, the generous and brave girl, who breaks the rules of submission, but unfortunately fails to become master of her fate. Particularly interesting in this chapter are the views on the family triangle presented by the author in the novel, the role of religion, or religious rites and the characteristics of women as the pride of society with morals and tradition but also as the incurable pain of time.

After all the work done on the study of the authors separately from each other, it has been considered important to conclude the work with **a fourth chapter**, called "Albanian sentimental prose in the comparative context", with a summary look, which will focus in the comparative confrontation of the commonalities among them. In this chapter we have been focused on comparisons mainly of the thematic-content plan of the creativity of Albanian and European authors.

Because of being authors of the same literary style, putting them next to each other helped us to highlight the similarities or any differences they have. Comparing them or even investigating the levels of intertextuality of one or the other author, has helped us to highlight the characteristics of all these authors. Comparative analyzes have been made, generally between Albanian and European sentimental prose. Although in all the previous chapters we have also made distinguishable, continuous comparisons, this chapter emphasizes and investigates more the essential elements that unites the Albanian sentimental prose itself as well as the Albanian sentimental prose with the European one. The intertextualities of communications that are expressed among these prose as well as between Spasses and Werther or Stermill and Richardson have been carefully observed, analyzing the novels in particular and other elements of prose in general.

We stopped to analyze the autobiographical story, the phenomenon of suicide, and the family relationships, which after have been studied, gave us different results that have been drawn from the comparative analysis.

What have we concluded for Albanian sentimental novels themselves and what are the conclusions when they are compared to European ones? During the thematic analysis on the novels of Albanian sentimental authors we have come to the conclusion that looking at this thematic aspect, the

literature of these authors touches on important themes or stories, those of Albanian patriarchy, emancipation of women-society, preservation of Albanian language and nation, blood feud, suicide, love, etc. Although in almost all novels we see these thematic aspects together, in the same narrative and literary text, each of the authors requires a special study access. The novels of these authors have themes and motifs that are occasionally transferred to each other. So, the themes that are more or less the same, are seen treated in some different novels. This makes their narrative more diverse and more attractive for reading and interpretation. The pen of Albanian sentimental authors, has exalted some of the characteristics of our people, such as sincere love for the country (homeland), pure love between a boy and a girl, honor, loyalty, but it has also unmasked old customs and habits that brought backwardness and poverty .

Due to the fact that the literary creativity of Mihal Grameno, Haki Stërmilli, Foqion Postoli, is a reflection of the life in that period of time, a reflection of the way they have seen and experienced, it represents a value in various fields of study such as thematic, ideological, motivational, stylistic, personal, political and history, because it is seen in a detailed way with a comprehensive and wide presentation, in order to come out with an interpretation from our personal point of view dealing with the spirit or the phenomenon of sentimentalism, which are present in their writings.

Keywords: *albanian literature, sentimentality, prose, authors*